

19.03.2018



C.nr.1024/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Ardian Ajvazi, në çështjen juridike, sipas padisë së paditësit [REDACTED] nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson avokatja [REDACTED] nga Ferizaj, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës-Ministria e Shëndetësisë-Spitali Rajonal Ferizaj, lidhur me kompensimin e pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse, vlera e objektit të kontestit 4,122.00 euro, me datë 07.02.2018 merr këtë:

### AKTGJYKIM

APROVOHET në tërësi kërkesëpadija e paditësit [REDACTED] nga Ferizaj dhe DETYROHET e paditura Qeveria e Kosovës-Ministria e Shëndetësisë-Spitali Rajonal Ferizaj që t'ia paguaj paditësit në emër të tri pagave jubilarë dhe tri pagave përcjellëse shumë e tërësishme prej 4,122.00 Euro, me kamat 8% nga dita e nxjerrjes së këtij Aktgjykimi e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 279.00 Euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të të njëjtit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

### Arsyetimi

Paditësi përmes të autorizuarës së tij me datë 10.11.2017, ka parashtruar padi, kundër të paditurës, lidhur kompensimin e pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse.

E autorizuarja e paditësit ka deklaruar: mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadijës për shpërblimin e pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse pas pensionimit dhe atë në lartësinë mesatare e pagave të fundit të realizuara para shkuarjes në pension, të cilën shumë sa i përket kamatës së precizuar në petitumin e padisë kërkojmë që të paguhet kamata në lartësi prej 8 % sipas dispozitave të LMD-së, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive. Paditësi ka punuar tek e paditura si mjek specialist sipas kontratës së punës duke filluar nga viti 1982 e deri në vitin 13.10.1990. Ka përvojë punë 34 vite, dhe kërkojmë nga gjykata ta aprovon kërkesëpadijën e paditësit për tri paga jubilarë sipas mesatares se tri pagave të fundit të realizuar të punëdhënësi i fundit dhe tri paga përcjellëse pas pensionimit shumë e tërësishme prej 4,122.00 Euro, dhe sipas dispozitave të marrëveshjes së përgjithshme kolektive të Republikës së Kosovës, që është në publikim nga data 01.01.2015, paditësit i takojnë tri paga jubilarë në kuptim të nenit 52 pika 1.2, ndërsa në kuptim të nenit 53 të njëjtës marrëveshje, paditësit i takojnë edhe tri paga përcjellëse për shkuarjen në pension, lartësinë e tri pagave mesatare mujore të fundit të realizuara te punëdhënësi i fundit. Sa i përket theksimeve në



Nga provat e elaboruar më lartë përkatësisht listën e pagave Gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se paditësi ka përvojë të punës 34 vite dhe se i takon e drejta në realizimin e tri pagave jubilarë në vlerë e tri pagave të fundit para pensionit në shumën prej 2,062.50 Euro si dhe tri pagave përcjellëse pas pensionimit në shumën prej 2,062.50 Euro. Paditësi ka realizuar pagë mujore në mujt e fundit para pensionimit në shumën prej 687.50 Euro.

Në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e cila është në fuqi që nga data 01.01.2015, në nenin 52 parashihet se i punësuar realizon shpërblimin jubilar në vlerën e tri pagave të fundit në qoftëse ka përvojë të punës 30 vjet, ndërsa paditësi e plotëson këtë kusht ligjor për arsye se ka përvojë të punës 34 vite, ndërsa në bazë të nenin 53 po ashtu paditësit i takojnë tri paga pas pensionimit në vlerën e tri pagave të fundit.

Pagat e shërbyesve civile, sektorit të arsimit, i shëndetësisë etj, financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe e paditura është orgazatë buxhetore. Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës e lidhur ndërmjet Odës Ekonomike të Kosovës, Aleanca Kosovare e Biznesit, Organizatat e të Punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës) si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës prodhon efekt juridike nga data e hyrjes në fuqi të saj 01.01.2015 dhe e paditura si organizat buxhetore është e detyruar t'ia paguaj paditësit shumat si në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

Nga faktet e treguara në padinë e paditësit si dhe nga provat dhe shkresat që gjenden në lëndë, rezulton si e bazuar kërkesëpadia e paditësit. Gjykata vërtetoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për të vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, e duke u bazuar në nenet 143 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr1024/17, me datë 07.02.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II UROŠEVAC


- AC. nr. 1930/18



Gjyqtari,

Ardian Ajvazi

Më 04.09.2018  
Dana

 KËSHILLAT JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas prapimit të kopjes së tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate.